

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 81066/17

**KE HIDROPROJEKT SHPK kundër Shqipërisë
dhe 3 kërkesa të tjera (shihni tabelën bashkëngjitur)**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 21 nëntor 2024, si Komitet i përbërë nga:

Oddný Mjöll Arnardóttir, *Kryetar,*

Úna Ní Raifeartaigh,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *Zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme të depozituara në datat e ndryshme të treguara në tabelën bashkëngjitur,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Lista e kërkesve jepet në shtojcë.

Ankimet e kërkesve sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës për kufizimet mbi të drejtën e tyre për akses në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë, si edhe një ankim sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 në lidhje me ndërhyrjen në të drejtat e pronës mbi një parcelë toke ju komunikuan qeverisë shqiptare, e cila paraqiti parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin.

Kërkesve iu kërqua të paraqesin prapësimet e tyre, si edhe pretendimet e tyre për shpërblim të drejtë. Përpjekjet e përsëritura të Sekretarisë për të kontaktuar kërkesit nuk ishin të suksesshme. Kërkesit nuk u përgjigjën.

Vëmendja e kërkesve u tërhoq nga neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen. Nuk pati asnjë përgjigje.

LEGJISLACIONI

Duke pasur parasysh objektin e ngjashëm të kërkesave, Gjykata e sheh të përshtatshme t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata del në përfundimin që mund të konsiderohet se kërkesit nuk dëshirojnë më të ndjekin kërkesat e tyre (neni 37 paragrafi 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në përputhje me nenin 37 paragrafi 1 (a) *in fine*, Gjykata nuk gjen rrethana të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut siç përcaktohen në Konventë dhe në protokollet e saj që kërkojnë vazhdimin e shqyrtimit të kërkesave.

Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht,

vendos të bashkojë kërkesat;

vendos të heqë kërkesat nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 12 dhjetor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË
DETYRË

Oddný Mjöll Arnardóttir
KRYETAR

SHTOJCË

Lista e kërkesave

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes/regjistrimit	Përfaqësuar nga
1	81066/17 24.11.2017	KE HIDROPROJEKT SHPK 1998	Aldo Shala
2	25006/18 20.5.2018	Fatmir KOÇI 1960	
3	37314/18 1.8.2018	Shpëtim SPAHIU 1957	
4	56523/18 20.11.2018	Xhaferr SHTËPANI 1944	Agron Lamaj